

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti për çështje ekonomike, me gjyqtaren Franciska Zhitia-Ymeri duke vendosur lidhur me çështjen juridike të paditësit Korporata Energjetike e Kosovës me seli në Prishtinë, të cilin e përfaqëson Zenel Shala nga Prishtina, ndaj të paditurës KUK C. me seli në P., të cilin e përfaqëson avokat R. B. nga P., lidhur me kompenzimin e dëmit në vlerë prej 26.798,87 euro , në seancën e shqyrtimit kryesor të datës; 21.11.2013, ndërsa me datën; 25.11.2013 merr këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit Korporata Energjetike e Kosovës me seli në Prishtinë, e paraqitur kundër të paditurit KUK C. me seli në P., për kompenzimin e dëmit në vlerë prej 26.798,87euro.

DETYROHET paditësi që në emër të shpenzimeve te procedurës kontestimore t'ia paguaj të paditurit shumën prej 527,60 euro.

A r s y e t i m

Paditësi Korporata Energjetike e Kosovës me seli në Prishtinë, përmes përfaqësuesit të saj Zenel Shala nga Prishtina,ka parashtruar padi ndaj KUK C. me seli në P., duke kërkuar që e paditura në emër të kompenzimit të dëmit në vlerë prej 26.798,87 euro, me kamatë ligjore 3.5% duke filluar nga data e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive,njëherit I ka kërkuar edhe shpenzimet e procedurës kontestimore.

E paditura në përgjigje në padi si dhe në seancën përgaditore e datës 18.09.2013 e ka kontestuar padinë dhe kërkespadinë në tërësi dhe ka propozuar që kërkespadia e paditësit të refuzohet për faktin se kemi të bëjmë me parashkrimin e kërkesës dhe atë të bazuar në LMD,përveq tjerash ai ka kundërshtuar edhe të gjitha pretendimet e paditësit lidhur me shfrytëzimin ilegal të energjis elektrike dhe të ketë shkaktuar dëm paditësit.Shpenzimet e procedurës kontestimore I ka kërkuar.

Gjykata gjatë shqyrtimit kryesor ka administruar këto prova : kallëzimin penal e datës 06.04.2007,procesverballi I përpiluar nga paditësi e dtaës 07.02.2007,fatura me nr.02/2007 e datës 07.02.2007,fotodokumentacioni,aktvendimi I konsumatorit D.P.Z me nr 9023966,parashtresa e paditësit e datës 03.10.2013,parashtresa e paditurës e datës 04.11.2013 të bashkangjitura edhe deftesat e dates 27.02.2004 me nr.1/43, dëftesa e dt 27.02.2004,dëftesa e datës 28.10.2004,dëftesa me nr.00771 e datës 28.10.2004.dëftesa me nr.00773 e datës 28.10.2004,dëftesa me nr.00772 e datës 28.10.2004.

Pas shqyrtimit dhe analizës së këtyre provave dhe pretendimeve të të dy palëve në procedurë Gjykata gjeti se kërkespadija e paditësit është e parashkruar dhe atë konformë nenit 377 të LMD-së, prandaj edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktygjykimi.

Gjykata nga kallëzimi penal ka vërtetuar se vepra penale është kryer me datë 07.02.2007, ndërsa me aktvendimin e Gjykatës Komunale në Prizren e datë 11.08.2010 është huldë poshtë propozimi akuza për shkak të parashkrimit relative të ndjekjes penale ,ky fakt I nevojshëm për të vërtetuar kohën e afatshme për paraqitjen e kërkesës lidhur me përmbushjen e detyrimit sipas nenit 377 të LMD-së, ka kaluar 3 vjet, andaj edhe është përmbush kushti ligjor për refuzimin e kërkespadijes si të pabazuar duke iu referuar nenit 377 dhe 376 të LMD-së.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e paditësit të cekura në shqyrtimin gjyqësor, në parashtrësë dhe në fjalën përfundimtare se paditësi e ka pranuar aktvendimin nga Gjykata Komunale në Prizren me datë 21.07.2011, dhe bazuar në këtë fakt ka parashtruar padin e saj me kohë, duke u bazuar në nenin 390 të LMD-së , Këto pretendime Gjykata i huldhi poshtë si të pabazuara meqenëse paditësi me kohë ka ditur për shkaktimin e dëmit, gjatë ndjekjes penale ka mund ta udhëheq edhe kontestin civil.

Pretendimi tjetër i paditësit se padin e paraqitur, tani e ka ndërprerë afatin e parashkrimit, sikurse parashihet në nenin 390 të LMD-së, nuk është i bazuar ngase kërkesa për kompenzimin e dëmit të shkaktuar me vepër penale paraqitet sipas nenit 377 të LMD-së, që do të thotë: Ndërpreja e parashkrimit të ndjekjes penale pas sjell edhe ndërprejen e parashkrimit të kërkesës për shpërblimin e dëmit, andaj sipas kësaj në rastin konkret kemi të bëjmë me parashkrimin e kërkesës për shpërblimin e dëmit të shkaktuar me vepër penale ngase është parashkruar edhe ndjekja penale.

Duke vendosur lidhur me aprovimin e kërkesës për shpenzimet e procedurës kontestimore gjykata është bazuar në nenin 452 të Ligjit për Procedurën Kontestimore të Kosovës, dhe atë për përfaqësimin e të të autorizuarit të palës së paditur shumën prej;405,60 euro në emër të tri përfaqësimeve, në emër të taksës lidhur përgjigjen në padi shumën prej;122,00 euro, ndërsa ka refuzuar shumën prej;200,00 euro në emër të humbjes s kohës për mbylljen e zyrës së tij derisa ka qenë në përfaqësim lidhur me këtë çështje juridike.

Gjykata pas shtjellimit të çështjes juridike civile të të paditësit lidhur me kompenzimin e dëmit në vlerë prej 26.798,87 euro, nuk është lëshuar në administrimin e provave të tjera, për faktin se kur kemi të bëjmë me parashkrimin e kërkesave atëherë nuk mund të vlersohen provat tjera të cilat nuk mund të jenë valide në marrjen e një vendimi meritator.

Nga të cekurat kjo Gjykatë ka vlersuar se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar në bazë të nenit 377 dhe 376 të LMD-së.

Gjykata pas shtjellimit të çështjes ka vendosur si në dispozitivin e këtij aktgjykimi duke u bazuar në nenin 143 paragrafi 1 të Ligjit të Procedurës Kontestimore të Kosovës.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për çështje ekonomike
III.C.nr.471/2012, me dt;25.11.2013

Gjyqtarja
Franciska Zhitia-Ymeri

UDHËZIME JURIDIKE: Ndaj këtij aktgjykimi është e lejuar e drejta e ankesës në afatin kohor prej 7 (shtatë) ditëve, duke llogaritur nga dita e pranimin të tij duke iu drejtuar Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj gjykate.